



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 10 AKTI

NR. 32 VENDIMI

Tiranë, më 5.07.2018

VENDIM

Trupa gjyqësore e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

Pamela Qirko (kryesuese)
Lulzim Hamitaj (anëtar)
Genta Tafa (Bungo) (relatore)

asistuar nga sekretare gjyqësore Znj. Olsida Goxhaj, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Znj. Marie Tuma, më datë 04.07.2018, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i dytë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Alma Ferjat Brati**, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE : **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (referuar më poshtë Kushtetuta).

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (referuar më poshtë ligji nr. 84/2016);

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPA GJYKUESE E KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, atë pasuror, të figurës dhe vlerësimin profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Brati, ushtron detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit Alma Ferjat Brati, duke qenë kandidat për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në bazë të nenit 276 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më datë 30.11.2017 në përputhje me “Rregullore për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në referim të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar menjëherë, pasi janë caktuar me short trupat gjyqësore të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe është shortuar shpërndarja e çështjes konkrete, më datë 30.11.2017.

Në mbledhjen e trupës gjyqësore të datës 14.12.2017 u caktua me mirëkuptim kryesuesi i trupës gjyqësore, zonja Pamela Qirko, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga relatorja dhe kryesuesja e trupës. Anëtarja tjetër e trupës, zonja Suela Zhegu, dha dorëheqjen për shkak

të konfliktit të interesit, dorëheqja u pranua nga trupa tjetër gjykuese me vendimin e datës 21.12.2017, që u ngrit për shqyrtimin e kësaj kërkesë dhe vendin e saj e zuri anëtari zëvendësues i trupës, zoti Lulzim Hamitaj. Në këtë mbledhje u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Alma Brati.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD).

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

Inspektoriati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. *** prot., datë 09.11.2017, në përputhje me nenin 33 të ligjit 84/2016; në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

- 1) *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- 2) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- 3) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- 4) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- 5) *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me atë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontaktet të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit 84/2016; në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit znj. Alma Brati.*

Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 21.12.2017.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

Trupa gjyquese, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 12.06.2018, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t`u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit më datë 12.06.2018. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes më datë 14.06.2018 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më datë 20.06.2018.

Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupa gjyquese, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, më datë 26.06.2018.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 04.07.2018, ora 12:00 paradite, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Znj. Marie Tuma.

Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Alma Brati ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ajo ka zbatuar me përpikmëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

V. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, datë 20.06.2018;
- dh) deklaratimet e personave të tjerë të lidhur.

Në deklaratën e pasurisë “Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 27.01.2017, **subjekti deklaroi këto pasuri** (të paluajtshme dhe të luajtshme) në emër të tij:

I. Apartament Banimi me sipërfaqe 100.1 m², ndodhur në Rr. “****”, blerë me kontratë shitje me rezervë nr. *** rep, *** kol, datë 9.09.2015, vlera 80.000 Euro.

Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës VETTING:

- *Kontratë Kredie e datës 23.09.2015 nr. *** rep., nr. *** kol. me Alpha Bank Albania në vlerën 7,000,000 Lekë konvertuar në 50,000 Euro.*
- *Hua e shlyer në vlerën 25.000 euro*
- *Kursime nga paga 5.000 euro*

Në lidhje me këtë apartament, subjekti ka vënë në dispozicion:

1. Kontratë shitje me rezervë nr. *** rep, *** kol, datë 9.09.2015;
2. Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol datë 1.10.2015;
3. Nxjerrje Llogarie nga Alpha Bank të noterit publik A.Sh.;
4. Mandat urdhër pagese, datë 10.09.2015;
5. Depozitë në arkë, datë 10.09.2015;
6. Mandat urdhër pagese, datë 18.09.2015;
7. Depozitë në arkë, datë 18.09.2015;
8. Disbursim kredie, datë 30.09.2015;
9. Mandat urdhër pagese, datë 30.09.2015;

10. Depozitë në *cash*, 30.09.2015;
11. Kontratë huaje nr. *** Rep., nr. *** kol, datë 23.09.2015;
12. Nxjerrje llogarie nga Alpha Bank për llogarinë e znj. Alma Brati;
13. Deklaratë e Alpha Bank, datë 11.01.2017;
14. Deklaratë noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, datë 20.2.2016.
15. Formular për tërheqje *cash* në valutë, datë 4.09.2015;
16. Formular për tërheqje *cash* në valutë, datë 17.09.2015;
17. Deklaratë noteriale nr. *** rep dhe nr. *** kol, datë 4.4.2013;
18. Kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme nr. *** rep, nr. *** kol, datë 07.09.2012;
19. Vërtetim nr. *** prot., datë 23.01.2017, i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
20. Librezë kursimi Procredit Bank;
21. Shkresë nr. *** prot., datë 26.01.2017, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës

Hetimi i kryer nga Komisioni:

- Shkresë nr. *** prot., datë 23.12.2017, drejtuar ZVRPP Tiranë.
Me shkresë nr. *** prot., datë 26.03.2018, ZVRPP Tiranë informon se znj. Alma Brati ka pasuri të paluajtshme apartament me sipërfaqe 100.1 m2, por dokumentacioni i regjistrimit është në mungesë në arkivën e ZVRPP-së.
- Shkresë nr. *** prot., datë 23.12.2017, drejtuar OSHEE.
Në datë 11.1.2018 me shkresën nr. *** prot., OSHEE informon se për subjektin e rivlerësimit ka vetëm një kontratë të hapur, adresa e së cilës korrespondon me adresën e shtëpisë së banimit të të deklaruar nga ana e saj.
- Shkresë nr. *** prot., datë 23.12.2017, drejtuar 27 bankave dhe institucioneve të tjera financiare.
Me shkresën nr. *** prot., datë 15.02.2018, Alpha Bank na vë në dispozicion të dhënat e kredisë si dhe të dhëna në lidhje me llogaritë bankare.
Me shkresën nr. *** prot., datë 29.12.2017, Raiffeisen Bank informon se: znj. E.B. dhe znj. D.P. kanë patur llogari bankare pranë kësaj banke.
Tirana Bank me shkresë nr. *** prot., datë 5.01.2018 informon se: znj. D.P. ka patur llogari bankare pranë kësaj banke.
Me shkresë nr. *** prot., datë 11.1.2018, Procredit Bank informon se: znj. E.B. ka patur llogari bankare pranë kësaj banke në monedhën Euro me vlerë fillestare 12,000 Euro. Nga gjendja e llogarisë rezulton se në datë 15.05.2006 është tërhequr 10,000 Euro.
BKT me shkresën *** prot., datë 11.01.2018 na informon se: znj. Alma Brati dhe znj. D.P. kanë patur llogari bankare në këtë bankë.

Me shkresën nr. *** prot., datë 15.02.2018 Credins Bank na informon se znj. D.P. ka depozitë në euro pranë kësaj banke.

- Shkresë nr. *** prot., datë 23.12.2017, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Me shkresën nr. *** prot., datë 04.01.2018, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve kthen përgjigje negative.

- Shkresë nr. *** prot., datë 17.1.2018, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës.

Me shkresën nr. *** prot., datë 08.02.2018, Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës na vë në dispozicion informacionin e kërkuar, në lidhje me babain e subjektit, zotin F.B.

- Shkresë nr. *** prot., datë 21.03.2018, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës.

Me shkresën nr. *** prot., datë 28.03.2018, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës na informon se:

Z. K.B. nuk figuron i regjistruar në asnjë subjekt nga janari 2012-janar 2018.

Znj. E.P. nuk merr pension pranë DRSSH Durrës.

- Shkresë nr. *** prot., datë 21.03.2018 drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër.

Me shkresë nr. *** prot., datë 28.03.2018 të DRT Shkodër rezulton se z. F.B. nuk ka qenë i regjistruar pranë organeve tatimore në Shkodër.

Me shkresën nr. *** prot., datë 27.03.2018 DRSSH Shkodër na informon se z. F.B. ka patur aktivitet privat si person fizik për periudhën 01.08.1996-30.12.1996.

- Shkresë nr. *** prot., datë 21.03.2018 drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës.

Me shkresën nr. *** prot., datë 06.04.2018 Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës na informon se z. K.B. figuron i regjistruar si person fizik me NIPT *** dhe ka status *pasiv* që më datë 19.03.2013.

- Shkresë nr. *** prot., datë 23.12.2017 drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Me shkresë nr. *** prot., datë 28.12.2017 QKB na vë në dispozicion informacionin e kërkuar

- Shkresë nr. *** prot., datë 17.04.2018 dhe shkresë nr. *** prot., datë 12.04.2018 drejtuar znj. E.B.

Deklaratë noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, datë 19.04.2018 e znj. E.B., vënë në dispozicion nga subjekti, në përgjigje të kërkesës për deklaram të nënës së saj, zonjës E.B.

Arsyetimi ligjor:

A. Subjekti i rivlerësimit ka blerë apartamentin me sipërfaqe 100.1 m², ndodhur në Rr. “****” nëpërmjet kontratës së shitjes me rezervë nr. *** rep., nr. *** kol, datë 9.09.2015.

1. Çmimi i shitjes ka qenë në **vlerën 80,000 Euro**, i cili është paguar me këste si më poshtë:

Kësti i parë prej 15,000 Euro, paguar në momentin e lidhjes së kontratës.

Bazuar në mandat urdhër pagese të datës 10.09.2015 të subjektit të rivlerësimit pranë Alpha Bank dhe nxjerrjen e llogarisë të noterit publik znj. A.Sh. për periudhën 10.09.2015-30.09.2015 në Alpha Bank, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka transferuar shumën 15,000 Euro më datë 10.09.2015 në llogarinë e noterit publik.

Ky veprim konfirmohet dhe nga nxjerrja e llogarisë së subjektit të rivlerësimit në Alpha Bank për periudhën 02.03.2009-10.02.2018 nga ku rezulton se në datë 10.09.2015 ajo ka depozituar shumën 15.000 Euro në Alpha Bank, shumë e cila është transferuar në po të njëjtën datë në llogari të noterit publik znj. A.Sh.

Kësti i dytë prej 15,000 Euro, paguar më datë 18.9.2015.

Bazuar në mandat urdhër pagese të datës 18.09.2015 të subjektit të rivlerësimit pranë Alpha Bank dhe nxjerrjen e llogarisë të noterit publik Znj. A.Sh. për periudhën 10.09.2015-30.09.2015 në Alpha Bank, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka transferuar shumën 15,000 Euro më datë 18.09.2015 në llogarinë e noterit publik.

Ky veprim konfirmohet dhe nga nxjerrja e llogarisë së subjektit të rivlerësimit në Alpha Bank për periudhën 02.03.2009-10.02.2018 nga ku rezulton se në datë 18.09.2015 ajo ka depozituar shumën 15.000 Euro në Alpha Bank, shumë e cila është transferuar në po të njëjtën datë në llogari të noterit publik znj. A.Sh.

Kësti i tretë prej 50,000 Euro, paguar më datë 30.09.2015.

Bazuar në mandat urdhër pagese të datës 30.09.2015 të subjektit të rivlerësimit pranë Alpha Bank dhe nxjerrjen e llogarisë të noterit publik znj. A.Sh. për periudhën 10.09.2015-30.09.2015 në Alpha Bank, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka transferuar shumën 50,000 Euro më datë 30.09.2015 në llogarinë e noterit publik.

Ky veprim konfirmohet dhe nga nxjerrja e llogarisë së subjektit të rivlerësimit në Alpha Bank për periudhën 02.03.2009-10.02.2018 nga ku rezulton se në datë 30.09.2015 asaj i është

kredituar shuma 50.000 Euro nga Alpha Bank, shumë e cila është transferuar në po të njëjtën datë në llogari të noterit publik znj. A.Sh.

Pagesa e kësteve të mësipërme konfirmohet dhe me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol. datë 1.10.2015 të shitësve të apartamentit A.K. dhe B.M.

2. Pronësia e subjektit të rivlerësimit mbi këtë apartament vërtetohet dhe nga ana e ZVRPP-së Tiranë (shkresë nr. *** prot.), e cila na informon se në emër të subjektit është e regjistruar vetëm një pasuri e paluajtshme: apartament me sipërfaqe 100.1 m². Për këtë apartament është regjistruar inskripti nr. ***, datë 29.09.2015. Dokumentacioni i regjistrimit të kësaj pasurie si dhe dokumentacioni i regjistrimit të kontratës së hipotekimit është në mungesë në arkivën e ZVRPP-së. Bazuar në Vërtetimin Hipotekor të datës 5.10.2015 të dorëzuar nga ana e subjektit të rivlerësimit, rezulton se apartamenti është regjistruar në emër të saj më datë 9.10.2015 me nr. hipotekor ***.

3. Subjektit i rivlerësimit deklaron se vlera e mobilimit të këtij apartamenti është 1, 500, 000 lekë. Me qëllim sqarimin e periudhës në të cilin është mobiluar ky apartament asaj iu kërkua informacion shtesë. Subjektit i rivlerësimit (shih dhe përgjigjen e dhënë për apartamentin e banimit në Durrës) sqaron se një pjesë të mobiljeve të ndodhur në shtëpinë e banimit në Durrës janë përdorur nga ana e saj për mobilimin e kësaj shtëpie, por duke mos përcaktuar vlerën e shpenzuar për mobilimin e këtij apartamenti gjatë vitit 2015-2016. Pavarësisht se në përgjigjen e saj është treguar konfuze, është e kuptueshme se mobilimi i shtëpisë në rrugën “****” është bërë edhe me mobilje ekzistuese, të përdorura nga subjekti më parë, por konfuzioni i treguar nuk na lejon të krijojmë një ide të qartë mbi vlerën e mobilimit të shtëpisë, që ishte edhe qëllimi i pyetjes së bërë për subjektin. Në këtë rast deklarimi i subjektit nuk ka qenë i plotë dhe korrekt. Për këtë arsye iu rikërkua dhe njëherë informacion në lidhje me mobilimin e këtij apartamenti. Subjektit i rivlerësimit është treguar korrekt në përgjigjen e kthyer, duke përcaktuar qartë blerjet e mobilieve të kryera për çdo vit, shoqëruar dhe me vlerën e shpenzimeve.¹

B. Në lidhje me burimin e të ardhurave të deklaruar për blerjen e këtij apartamenti, subjekti rivlerësimit për këtë apartament ka deklaruar se burimi i të ardhurave për këtë apartament është:

1. 7,000,000 lekë (50.000 euro) kredi marrë nga Alpha Bank;

¹Ju keni deklaruar se apartamenti juaj ka mobilim në vlerën 1,500,000 lekë, ju lutem të na informoni kur i keni kryer shpenzimet për mobilim duke përcaktuar vitin dhe shumën e harxhuar për çdo vit.

Përgjigje: Po, vlera e mobilimit të shtëpisë është rreth 1.500.000 lekë; sende të cilat janë blerë në periudhat si më poshtë:

Një dhomë gjumi fëmijësh, me kënd pune në vlerën 170.000 lekë, bërë në vitin 2003-2004;

Kënd për ndenje, një etazher, lavatriçe në vlerën 172.000 lekë, blerë vitin 2008;

Sobë+ syprinë + aspirator, frigorifer, abazhur dhe një pajisje fiskulture, në vlerën 277.000, blerë në vitin 2009.

Dy raftë të vegjël, kondicioner dhe një biçiklete për fiskulturë, në vlerën 160.000 lekë, blerë në vitin 2010.

Tavolinë mesi dhe buke në vlerën 100.000 lekë, blerë në vitin 2011.

K/bufe, dhomë gjumi dhe një dhomë e vogël për njërin fëmijë në vlerën 590.000 lekë, bërë në vitin 2015.

2. 25.000 euro (3, 441, 250 lekë) hua marrë nga tezja e saj;
3. Shuma e mbetur prej 688,250 lekë (5.000 euro) janë kursime nga paga.

1. Në datë 23.09.2015 subjektit i rivlerësimit ka lidhur kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol. me Alpha Bank për marrjen hua të shumës 7,000,000 lekë me afat 240 muaj ose 20 vjet. Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit të rivlerësimit në Alpha Bank për periudhën 02.03.2009-10.02.2018 rezulton se më datë 30.09.2015 nga kjo bankë i është kredituar shuma 50.000 Euro, e cila është transferuar në po të njëjtën datë në llogari të noterit publik znj. A.Sh.

Detyrimi i mbetur për kredinë e marrë ndaj Alpha Bank deri më datë 31.12.2016 është në shumën prej **6,678,440 lekë**.

2. Hua në shumën 25.000 Euro marrë nga tezja znj. D.P., vërtetuar me deklaratë noteriale nr. *** rep nr. *** kol, datë 20.2.2016.
 - Për këtë subjekti ka vënë në dispozicion si dokument provues deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.2.2016. Në këtë deklaratë noteriale përcaktohet se subjekti i rivlerësimit i ka marrë hua shumën 25.000 euro tezes së saj dhe se afati i pagesës për shlyerjen e huasë do të jetë 30 ditë nga momenti i shitjes së pasurisë banesë dykatëshe, e ndodhur në adresën Lagjja Nr. ***, Rruga “****”, Durrës, në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

Dhënia e huasë në shumën 25.000 euro vërtetohet nga nxjerrja e llogarisë në BKT të subjektit të rivlerësimit nga ku rezulton se kjo shumë është kaluar në llogarinë e saj në dy këste, përkatësisht 15.000 euro i janë kaluar më datë 4.09.2015 dhe 10.000 euro i janë kaluar më 16.09.2015.

- Komisioni hetoi në lidhje me aftësinë e znj. D.P. për të dhënë hua shumën 25.000 euro. Nga hetimi rezulton se:

Znj. D.P. ka patur ose ka llogari bankare në:

- ✚ **Credins Bank** me gjendje 5.000 Euro;
- ✚ **Raiffeisen bank**, në llogarinë në lekë ka patur vlerë fillestare 142,000 lekë, ndërsa në llogarinë në euro ka patur vlerë fillestare 3.087,76 euro;
- ✚ **Tirana Bank** ka patur llogari në monedhën Euro me vlerë fillestare 30. 000 Euro, në këtë llogari ka patur të drejtë veprimi dhe znj. E.L.M. znj. D.P. ka qenë dhe ofruese kolaterali për kredinë e znj. E.L.M.
- ✚ **BKT** ka patur 5 llogari bankare (së bashku me znj. M.P.) në këtë bankë, nga të cilat vetëm njëra është mbyllur.

| Lloji Llogarisë | Vlera fillestare | Vlera Përfundimtare |
|--------------------------|------------------|---------------------|
| Llogari në Lekë | 2,000 | 858,980.73 |
| Llogari Depozite Euro | 43.500 | 29,227.59 |
| Llogari Euro | 11,000 | 66,663.73 |
| Llogari ne Lekë | 507,000 | 0 |
| Llogari Euro | 29,227.59 | 31.934.83 |
| Depozitë një mujore Euro | 9,000 | |

Nga nxjerrja e llogarive në BKT, në emër të znj. D.P. dhe znj. M.P. rezulton se është kaluar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit shuma 25.000 në dy këste, përkatësisht 15.000 euro i janë kaluar më datë 4.09.2015 dhe 10.000 euro i janë kaluar më datë 16.09.2015. Nga analiza e provave Komisioni çmon se zonja P. i kishte mundësitë financiare për dhënien e kësaj huaje.

- Nga analiza e dokumentacionit bankar për llogarinë e subjektit të rivlerësimit, Komisioni konstatoi se rezulton që shuma prej 15,000 Euro është kaluar nga M.P. tek znj. Alma Brati si kthim detyrimi dhe jo si dhënie huaje siç deklaroi subjekti, i njëjti përshkrim rezulton dhe në nxjerrjen e llogarisë të M. ose D.P.

Duke qenë se kishte një mospërputhje midis të dhënave të bankës dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, këtij të fundit iu kërkua informacion shtesë. Në datë 27.02.2018 ajo ka sqaruar se nuk ka patur marrëdhënie detyrimi me znj. M.P. dhe se shënimi kthim detyrimi ka qënë i gabuar. Për të vërtetuar deklarin e saj ka vënë në dispozicion kopjen e transferimit të datës 04.09.2015 të BKT-së për shumën 15.000 euro të firmosur nga znj. D.P. nga ku rezulton se është shënuar “D.P. kalon për Alma Bratin, dhënie hua.”

Për sa më sipër rezulton se shënimi “kthim detyrimi” është vendosur gabimisht nga ana e Bankës.

- Subjektit i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” nuk dokumenton me dokumentacion provues bankar dhe noterial shlyerjen e huasë në shumën 25.000 Euro.

Gjatë hetimit administrativ subjektit i rivlerësimit ka depozituar deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.02.2018, nëpërmjet së cilës znj. D.P., deklaroi se mbesa e saj i ka shlyer në muajin gusht të vitit 2016 huanë e dhënë prej saj. Nga analizimi i lëvizjeve bankare të subjektit të rivlerësimit nuk rezulton të jetë kryer ndonjë pagesë për llogari të tezes së saj gjatë viteve 2016-2018 sikurse rezulton transferimi i huasë në vlerën 25.000 euro.

Në lidhje me këtë, subjekti i rivlerësimit, në qëndrimin e saj ndaj rezultateve të hetimit, sqaron se në momentin e marrjes së kësaj huaje, zonja P., teza e saj, ndodhej në Sarandë. Për shkak të shpejtësisë së veprimeve kontraktuale që do të kryheshin për pagesën e apartamentit, veprimet u bënë nëpërmjet bankës. Ndërsa kthimi i kësaj huaje është bërë *cash*, duke u formalizuar më pas me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.02.2018.

- Në lidhje me huanë e mësipërme subjekti deklaroi se e ka shlyer tezen e saj me kursimet e saj dhe të mamasë së saj gjatë vitit 2016. Përkatësisht 1,700,000 lekë kursimet personale ndër vite dhe 1,800,000 lekë dhuratë nga mamaja.
- ◆ Me qëllim vërtetimit të deklaramëve të subjektit në lidhje me aftësinë e saj financiare për të kursyer shumën 1,700,000 lekë, nga analiza financiare për vitet 2014-2015 rezultoi se:
 - ✚ Në vitin 2014 subjekti i rivlerësimit deklaroi për herë të parë se ka kursyer shumën prej 1,100,000 lekë. Kjo shumë është konfirmuar nga ana e saj dhe në kthimin e përgjigjes të datës 24.05.2018. Bazuar në tabelën e mëposhtme ku janë pasqyruar:
 - **Të ardhurat e subjektit të rivlerësimit** ku përfshihen të ardhurat nga paga, nga pensioni ushqimor dhe të ardhurat nga pensioni i nënës.
 - **Shpenzimet e subjektit të rivlerësimit** ku përfshihen shpenzimet minimale të jetesës sipas ILDKPKI-së, pagesa e qirasë së apartamentit të banimit dhe pagesa për udhëtimet. Në këtë zë do të përfshihet dhe shuma 1,100,000 lekë e cila deklarohet se është kursyer nga ana e subjektit të rivlerësimit gjatë vitit 2014.

| Viti 2014 | | | | Diferenca (I-II) |
|------------------------|-----------------------|---|-----------------------|-----------------------|
| Të ardhurat (I) | 1,779,442 lekë | Shpenzimet (II) | 1,878,187 lekë | |
| Pensioni i nënës | 242,088 | Shpenzimet e jetesës sipas ILDKPKI | 540,000 | |
| Paga | 1,297,354 | Shpenzime udhëtimi të deklaruara nga subjekti | 238,187 | |
| Pensioni Ushqimor | 240,000 | Kursime nga paga | 1,100,000 | (-98,745 lekë) |

Nga analiza financiare e mësipërme Komisioni konstatoi se subjekti nuk mund të kursente shumën prej 1 100 000, por vetëm 1 000 000 lekë.

E njohur me këtë rezultat të hetimit, subjekti, në qëndrimin e tij shprehet se “Është i saktë konstatimi juaj, se në vitin 2014 kursimi im duhet të ishte 1.000.000 lekë. Vlera e deklaruar nga ana ime 1.100.000 lekë, ka pasur të përshirë edhe shumën 100.000 lekë, gjendje nga vlera e shitjes së makinës së markës Golf, e cila nuk ishte deklaruar më parë dhe në shtator 2014 është bërë saktësimi i këtij fakti pranë ILDKPKI (shih procesverbalin e Shtator 2014).”

Në këtë procesverbal, të cilin Komisioni e disponon nëpërmjet ILDKPKI, subjekti ka deklaruar harresën në deklarimin e shitjes së një automjeti më datë 15.08.2012, me çmim 100 000 lekë.

Në vlerësim të këtij deklarami të subjektit, Komisioni çmon se subjekti nuk të krijon bindjen se kjo vlerë prej 100 000 lekë është mbajtur e papërdorur dhe e padeklaruar deri në fund të vitit 2014.

- Në vitin 2015 subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka kursyer shumën prej 1,100,000 lekë, kjo shumë është konfirmuar nga ana e saj dhe në kthimin e përgjigjes të datës 24.05.2018.

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar:

- Të ardhurat e subjektit të rivlerësimit**, ku përfshihen të ardhurat nga paga, nga pensioni ushqimor dhe të ardhurat nga pensioni i nënës. Në përgjigjet e datës 24.05.2018 subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka marrë shumën 600 000² lekë si të ardhur nga pensioni ushqimor, por nuk e mbështet në dokumentacion provues marrjen e kësaj shume. Në deklaramin vjetor të pasurisë kjo shumë është deklaruar 240 000 lekë dhe jo 600 000 lekë, siç është deklaruar në deklaratën “Vetting”.
- Shpenzimet e subjektit të rivlerësimit** ku përfshihen shpenzimet minimale të jetesës sipas ILDKPI-së, pagesa e qirasë së apartamentit të banimit, shpenzimet për pagesën e kredisë. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka kryer arredimin e apartamentit në shumën 590,000 lekë. Në këtë zë do të përfshihet dhe shuma 1,100,000 lekë, e cila deklarohet se është kursyer nga ana e subjektit të rivlerësimit gjatë vitit 2015.

Diferenca e pambuluar me kredinë dhe huanë e marrë nga teza e saj për blerjen e shtëpisë në shumën 5.000 euro ose **688,250 lekë**³ nuk do të përfshihet në zërit shpenzime, pasi subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo shumë ka si burim kursimet e saj ndër vite (2014).

| Viti 2015 | | | | Diferenca (I-II) |
|--------------------|----------------|---|----------------------|-------------------------|
| Të ardhurat (I) | 2,120,259 lekë | Shpenzimet (II) | 2,373,013 | |
| Pensionin i nënës | 242,088 | Shpenzimet e jetesës sipas ILDKPKI | 540,000 | |
| Paga | 1,278,171 | Arredimi i Apartamentit (Vetëdeklaruar nga subjekti) | 590,000 | |
| Pensionin Ushqimor | 600,000 | Shlyerje Kredie | 143,013 ⁴ | (- 252,754 lekë) |

² Në përgjigjet e datës 24.05.2018 ajo sqaron se: Për vitin 2015 kam përfituar pension ushqimore në shumën 50000 lekë në muaj që nga janari 2015 e në vijim, kjo është bërë me marrëveshje me ish-bashkëshortin, pasi fëmijët vazhdonin studimet, dhe shpenzimet ishin shtuar, si prindër kemi detyrimin të kontribuojmë deri në 25 vjeç sipas Kodit të Familjes.

Për shkak të mungesës së dokumentacionit është shënuar 240 000 lekë, por në vitin 2016 vlerësova se pavarësisht se nuk kisha dokument fakti që unë e merrja këtë vlerë duhet ta shënoja dhe për vitin 2016 e kam shënuar. Meqenëse ligji për vetingun kërkonte dhe dokumentacion atëherë i kërkova ish-bashkëshortit ta dokumentonte këtë vlerë meqenëse duhet për efekt dokumentacioni, dhe në kushtet që realisht e paguante këtë shumë.

³ Konvertuar në lekë bazuar në kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2015

⁴ Sipas dokumentacionit të marrë nga Alpha Bank për vitin 2015 subjekti ka shlyer 53,244 lekë principal dhe 89,769 lekë interes, në total ka shlyer 143,013 lekë.

| | | | |
|-------------------------------|--|------------------|-----------|
| | | (Kësti) | |
| Kursime nga vitit 2014 | | Kursime nga paga | 1,100,000 |
| 311,750⁵ | | | |

Nga analiza financiare e mësipërme, Komisioni konstatoi se subjekti nuk mund të kursente shumën prej 1,100,000, por vetëm 847, 246 lekë.

Në qëndrimin e tij ndaj rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi se: “Sipas të dhënave të pasqyruara në tabelën për vitin 2015, është konstatuar nga ana juaj se nga vitin 2014, kanë ngelur kursime në vlerën 311,750 lekë, e cila megjithëse e përfshirë në zërin të ardhurat e kursimit për 2014 në tabelë, nuk është mbledhur në vlerën totale, në seksionin “të ardhurat”. Në tabelë të ardhurat duhet të ishin 2.432.009 lekë dhe diferenca del: 2,432,009-2,373,013= 58,996 lekë.”

Në lidhje me këtë konstatim të subjektit, Komisioni vlerëson se në tabelën ku është analizuar gjendja financiare e subjektit për vitin 2015, është marrë i mirëqenë deklarimi i subjektit në lidhje me kursimet e vitit 2014, por duke qenë se Komisionit nuk iu krijua bindja në lidhje me këtë fakt, çmon se në përfundim të analizës financiare të të dy viteve 2014-2015, subjekti rezultoi me rezultat negativ në shumën 39 749 lekë. Ky rezultat vjen si rrjedhojë e përfshirjes edhe të shumës prej 311,750 lekë, që janë kursimet nga të ardhurat e vitit 2014 dhe sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit është pjesë e kursimeve për vitin 2015. Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i saktë në deklaratimet ndër vite në lidhje me deklarin e shtesave dhe pakësimeve të të ardhurave të saj. Si rezultat i kësaj rrjedh dhe vlera negative në periudhën 2014-2015.

- ◆ Për të vërtetuar aftësinë financiare të nënës së saj për t’i dhuruar shumën 1,800,000 lekë, subjektit i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën noteriale nr. *** rep., dhe nr. ***kol., datë 4.4.2013 (e cila nuk rezultoi e deklaruar në DPPP) nëpërmjet së cilës z. H.B. deklaroi se: “*I ka marrë borxh në datë 4.6.2006 verbalisht znj. E.B. shumën 4,000,000 lekë me qëllim kryerjen e investimeve në objektin Hotel-Restorant “***”.* Më datë 31.05.2011 i ka kthyer shumën 1,500,000 lekë, ndërsa më datë 4.4.2013 i kthen shumën 2,500,000 lekë” .

Me qëllim vërtetimit të deklarimeve dhe dokumentacionit të dorëzuar nga ana e subjektit të rivlerësimit në lidhje me aftësinë financiare të nënës së saj për t’i dhuruar shumën 1,800,000 lekë, Komisioni zhvilloi një hetim administrativ të thelluar, nga i cili rezultoi se:

- ✚ Bazuar në shkresën e Procredit Bank nr. ***, datë 11.1.2018 znj. E.B. ka patur llogari bankare pranë kësaj banke në monedhën Euro me vlerë fillestare në datë 13.3.2006 në shumën 12,000 Euro. Nga gjendja e llogarisë rezultoi se në datë 15.05.2006 është

⁵ Në deklaratën periodike vjetore të viti 2014, subjekti ka deklaruar kursime në shumën 1,100,000 lekë, në vitin 2015 ka deklaruar pakësim nga kursimet *cash* në vlerën prej 5,000 Eurosh për të shlyer detyrimin ndaj shoqërisë ndërtuese për blerjen e apartamentit duke i mbetur si kursime nga vitit 2014 shuma 311,750 lekë.

tërhequr shuma 10.000 Euro dhe në datën 23.02.2007 është tërhequr shuma e mbetur prej 2.000 euro. Me shkresën nr. *** prot., datë 29.12.2017 të Raiffeisen Bank rezulton se znj. E.B. ka patur llogari në lekë hapur më datë 05.04.2007 dhe mbyllur më datë 16.1.2017 me vlerë fillestare 500,000 lekë.

Nga të dhënat bankare rezulton se mamaja e subjektit të rivlerësimit ka patur aftësi financiare në shumën 10.000 euro për t'i dhënë hua z. H.B., ndërsa për pjesën tjetër të shumës në vlerë 2,770,000 lekë nuk ka asnjë dokument provues për të vërtetuar që ajo ka patur gjendje këtë shumë. Në lidhje me këtë fakt subjektit të rivlerësimit iu kërkua informacion shtesë. Nga ana e saj deklarohet se të ardhurat në shumën 4,000,000 lekë e kanë burimin nga paga e dy prindërve të saj.

Mbështetur në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit nga ana e Komisionit iu dërguan shkresa, Drejtorisë Rajonale Tatimore dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër dhe Durrës.

Nga informacioni i administruar prej tyre rezulton se:

- Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër informon se z. F.B. nuk ka qenë i regjistruar në organet tatimore Shkodër.
- Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës për znj. E.B. dhe z. F.B. na informon se nuk ka të dhëna për këta shtetas.
- DRSSH Shkodër informon se z. F.B. ka patur aktivitet privat si person fizik për periudhën 01.08.1996-30.12.1996.
- Bazuar në shkresën Nr. *** prot., datë 08.02.2018 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, Z. F.B. ka kryer deklaratimet sipas tabelës së më poshtme:

| Viti | Xhiro/Lekë | Pagim tatimi mbi të ardhurat/Lekë | Sigurime shoqërore/lekë | Vlera e qerasë/lekë | Fitimi |
|---------------|-------------|---|----------------------------------|-------------------------|-----------|
| 1999 | 200,000 | 23,350 | | 8000*12 total 96,000 | 80,650 |
| 2000 | 1,100,000 | 80,000 | 6,645*12 muaj total 79,740 | | 940,260 |
| 2001 | 1,220,000 | 72,000 | 7,773*12 muaj total 93,276 | | 1,056,724 |
| 2002 | 644,000 | 150,000 | | 96,000 | 398,000 |
| 2003- 2014 | Nuk ka info | | | | |

Bazuar në informacionin e administruar më sipër rezulton se z. F.B. ka përfituar shumën prej 2,475,634 lekë. Nëse kësaj shume i zbrisim shumën 975,000 lekë me të cilën është blerë

shtëpia e banimit dhe shumë 480,000 lekë për shpenzimet e jetesës për periudhën 1999-2002 (për periudhën 1999-2002 është marrë si shpenzim mesatar konsumi shuma prej 10,000 lekë/muaj) rezulton se deri në vitin 2003 z. F.B. ka patur mundësi të kursente shumë **1,020,634 lekë**. Kjo vlerë i përafrohet të dhënave të siguruara nga sistemi bankar (Procredit Bank 12.000 euro).

Nga certifikata e regjistrimit në organin tatimor me kod fiskal *** rezulton se z. F.B. është regjistruar me vendim gjykatë nr. 11760, datë 03.09.1999.

Pasi u njoh me këtë rezultat të hetimit, subjekti parashtrori: “Prindërit e mi kanë punuar: nëna ime E.B. 34 vjet punë, për të cilat merr pension, ndërsa babai im F.B. ka pasur, 27 vjet punë si prokuror dhe 1994-2005 si avokat, vite të cilat kanë grumbulluar edhe të ardhura, të cilat nuk mund të dokumentohen tërësisht, për shkak se janë djegur në trazirat e vitit 1997.”

Në përfundim të hetimit, pasi u njoh edhe me parashtrimin e subjektit, Komisioni vlerëson se nuk vërtetohet me dokumenta burimi i ligjshëm për shumë prej 4 000 000 lekësh, në pronësi të F. dhe E.B., pavarësisht deklaratës noteriale të nënshkruar nga zoti H.B. Kjo deklaratë mund të vërtetohet shlyerjen e huasë si marrëdhënie midis këtyre dy palëve, por jo lëvrimin real të të hollave. Gjithashtu nuk u provua me dokumentacion as ekzistenca e kësaj shume prej 4 000 000 lekësh.

Nisur nga fakti se procesit të rivlerësimit kalimtar i nënshtrohet subjekti i rivlerësimit, zonja Alma Brati, Komisioni çmon se fokusi i hetimit dhe vlerësimit do të duhet të jetë shuma që është përfituar nga ky subjekt nëpërmjet dhurimit nga e ëma, E.B. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë patur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar kursime në shumë 1,800,000 lekë. Ky konstatim bazohet në të dhënat e administruar nga bankat si dhe organet tatimore nga ku rezulton se në vitin 2006, kohë në të cilën subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në detyrën e gjyqtarit, nëna e subjektit të rivlerësimit kishte të ardhura në banka në shumë 12.000 euro, vlerë e përafërt me shumë e dhuruar nga ana e saj subjektit të rivlerësimit. Në përfundim vlerësohet se shuma prej 1 800 000 lekësh, e përfituar nga subjekti duhet të konsiderohet si e ardhur me burime të ligjshme.

✚ Nga ana e Subjektit të Rivlerësimit nuk dokumentohet me dokument provues dhurimi i kryer nga ana e mamasë të saj. Duke qenë se kemi të bëjmë me një shumë të konsiderueshme të hollash, ajo minimalisht duhet të bënte një deklaratë të thjeshtë për të vërtetuar marrjen e kësaj shume. Në këto kushte për të vërtetuar dhurimin e mamasë së subjektit të rivlerësimit në shumë 1,800,000 lekë në zbatim të të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe të aneksit Ç pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë iu drejtuam me shkresë zyrtare znj. E.B. për të dhënë deklaratimet e saj në lidhje me burimin e të ardhurave shoqëruar me dokumentacion provues për shumë e dhuruar.

Subjektit i rivlerësimit na informoi se nëna e saj e ka të pamundur të paraqitet pranë KPK-së për shkak të gjendjes shëndetësore jo të mirë, por në kuadër të bashkëpunimit na ka vënë

në dispozicion deklaratën noteriale nr. *** rep dhe nr. *** kol, të datës 19.04.2018 të znj. E.B. nëpërmjet së cilës ajo konfirmon se i ka dhuruar vajzës së saj znj. Alma Brati shumë prej 1,800,000 lekë për të shlyer detyrimin që kishte ndaj motrës së saj znj. D.P.

Në përfundim të kësaj analize, vërehet se:

- ➔ përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat e administruara;
- ➔ subjekti ka patur mundësi financiare për këtë pasuri të paluajtshme;
- ➔ konstatohen pasaktësi të vogla në deklarime ndër vite, të cilat kanë ndikuar dhe në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, por prej të cilave nuk lindin dyshime të arsyeshme për shkelje të mundshme ligjore.

II. Shtëpi banimi në Durrës, Lagjja nr. *, Rr. “****”, me sipërfaqe trualli 179.84 m² dhe sip. ndërtimi 85.34 m², blerë me kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.02.2002 në vlerën totale 1,950,000 lekë. ¼ pronësi.**

Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës “Vetting”:

Të ardhura nga pagat për periudhën deri në vitin 2002.

Për këtë pasuri, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Certifikatë pronësie, lëshuar më datë 12.10.2005;
- Kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.02.2002.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit

➤ Shkresë nr. *** prot., datë 23.12.2017 drejtuar noter A. G.
Në datë 29.12.2017 noteri A. G. ka na vënë në dispozicion kontratën e shitblerjes nr. *** rep. dhe nr. *** kol., duke deklaruar se e ka nxjerrë nga arkivi i tij dhe se dokumentet nuk kanë korrigjime, fshirje apo shenja të veçanta.

➤ Shkresë nr. *** prot., datë 12.04.2018 drejtuar noter A. G.
Në datë 19.04.2018 noteri publik A. G. na informon mbi arsyet se pse kemi dy kontrata në format të ndryshme, pavarësisht se kanë të njëjtin numër repertori dhe numër koleksioni.

Më datë 20.04.2018 Ministria e Drejtësisë me shkresë nr. ***prot i kërkon noterit të vërë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar nga Komisioni.

- Shkresë nr. *** prot., datë 08.05.2018 drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.

Shkresë nr. *** prot., datë 08.06.2018, kthim përgjigjeje nga Ministria e Drejtësisë.

- Shkresë nr. *** prot., datë 23.12.2017 Drejtuar ZVRPP Durrës.

Shkresë nr. *** prot., datë 26.01.2018 ZVRPP Durrës na informon se: znj. Alma Brati ka vetëm një pasuri në Durrës në bashkëpronësi.

Arsyetimi ligjor:

Shtëpia e banimit në Durrës është blerë me kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol. datë 20.2.2002 me pala shitëse S.H.B. i datëlindjes 5.6.1923 dhe pala blerëse F.B., E.B. (prindërit e subjektit), K.B. (ish-bashkëshorti i subjektit) dhe Alma Brati. Në këtë kontratë parashikohet shitja e pasurisë nr. *** me sipërfaqe 158 m² me çmimin 1,950,000 Lekë. Në planvendosje bashkëlidhur kontratës ka një shënim: *Banesa është dykatëshe me konstruksion mur tulle e mbuluar me çati me dy dhoma, banjo e korridor në çdo kat. Banesa shitet bashkë me truall me sipërfaqe 158 m², ndërsa sipërfaqja 167 m² i mbetet pronarit.*

Referuar vërtetimit nga dokumenti hipotekor i datës 14.2.2002 rezulton se sipërfaqja totale e kësaj pasurie është 325 m² dhe është vetëm truall, ndërsa bazuar në kartelën e pasurisë së paluajtshme ardhur më datë 26.01.2018 nga ZVRPP Durrës, rezulton se shtëpia e banimit ka një sipërfaqe truall 179.84 m² dhe ndërtesë 85.34 m², sipërfaqe e cila nuk korrespondon me kontratën e shitjes ku sipërfaqja e blerë është 158 m².

Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga ana e ZVRPP Durrës me shkresën Nr. *** prot., datë 26.01.2018 rezulton se për regjistrimin e kësaj pasurie pranë ZVRPP Durrës është depozituar një kontratë e ndryshme shitje me të njëjtat të dhëna për sa i përket numrit të repertorit dhe numrit të koleksionit të aktit noterial, ndërsa përmbajtja ndryshon si në format (pasi ajo e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit është e punuar me kompjuter, ndërsa ajo e ZVRPP është me makinë shkrimi) ashtu dhe në përmbajtje.

Nga analiza e këtyre dy kontratave, Komisioni konstatoi se ndryshimet janë të tilla, që nuk sjellin pasoja në objektin dhe çmimin e përcaktuar në të.

Me qëllim sqarimin e faktit të ekzistencës së dy kontratave me përmbajtje dhe formë të ndryshme, por me të njëjtin numër repertori dhe numër koleksioni iu kërkua një informacion i detajuar noterit publik. Deklarimet e noterit janë të paqartë, jo të sakta dhe nuk justifikojnë ekzistencën e dy kontratave të ndryshme. Për sqarim të mëtejshëm, Komisioni i kërkoi Ministrisë së Drejtësisë ushtrimin e kontrollit në dokumentacionin e këtij noteri, me qëllim qartësimin e situatës.

Me shkresën nr. *** prot., datë 08.06.2018, Ministria e Drejtësisë na informon se, pas verifikimit të dokumentacionit, ka konstatuar shkelje nga ana e noterit publik.

Në vlerësim të kësaj analize, Komisioni çmon se subjekti nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për veprimet e noterit, të gjitha këto fakte të renditura më sipër nuk ndikojnë në marrëdhënien korrekte të pronësisë së subjektit me pronën.

Me kontratë shitblerje nr. *** kol dhe nr. *** rep datë 28.04.2005 pjesa takuese e babait të subjektit i është shitur nënës së subjektit.

Për këtë banesë subjektit iu kërkua informacion në lidhje me mobilimin, punimet e kryera, nëse është dhënë me qira. Nga përgjigjet e saj rezulton se në vitin 2002-2003 është bërë rinovimi i kësaj shtëpi dhe se një pjesë e mobiljeve janë përdorur gjatë viteve që ka qëndruar me qira dhe më pas në apartamentin e ri të ndodhur në Rr. “****”. Aktualisht shtëpia përdoret nga ish-bashkëshorti. Këto përgjigje konfirmojnë edhe njëherë qëndrimin e subjektit në lidhje me shpenzimet që ka kryer për mobilimin e shtëpisë së blerë në vitin 2015. Deklarimi i subjektit konfirmohet edhe nga ish-bashkëshorti në deklarin e tij përpara Komisionit.

Në përfundim të kësaj analize, konstatohet se:

- ➔ përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat e administruara;
- ➔ subjekti ka patur mundësi financiare për këtë pasuri të paluajtshme.

III. Autoveturë Mazda me targë *** dhe vlerë 15,900 Euro, blerë me kontratë porosie, më datë 08.06.2011, vijuar me kontratën e qirasë financiare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.06.2011, vijuar me kontratën e blerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.05.2013 me Raiffeisen Leasing.

Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: *Në momentin e lidhjes së kontratës u pagua 40% e vlerës ose (6.360 Euro) nga të ardhura familjare, pjesa tjetër me kredi nga Raiffeisen Leasing.*

Në lidhje me këtë depozitë kursimi, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Kontratë shitblerje, datë 08.06.2011;
- Kontratë qiraje financiare nr. *** rep, nr. *** kol datë 13.06.2011;
- Kontratë shitblerje automjeti nr. *** Rep. dhe nr. *** kol., datë 14.05.2013;
- Vërtetim nr. ***, datë 18.10.2016 i Raiffeisen Bank.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. *** prot., datë 23.12.2017 drejtuar 27 bankave dhe institucioneve të tjera financiare.

Me shkresë nr. *** prot., datë 9.1.2018 Raiffeisen Leasing informon se:

*Alma Brati ka patur një financim leasing, kontratë nr. ***, datë 13.06.2011, që është mbyllur më datë 14.05.2013.*

Me shkresë nr. *** prot., datë 29.12.2017 Raiffeisen Bank informon se: *Alma Brati ka patur llogari në Lekë (pagë) mbyllur më datë 4.11.2011 dhe në euro mbyllur në datë 16.01.2017.*

- Shkresë Nr. *** Prot., datë 23.12.2017 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Me shkresë nr. *** prot., datë 10.1.2018 DPSHTRR na informon:

*Subjekti i Rivlerësimit ka të regjistruar automjetin me targa ***.*

Me shkresë nr. *** prot., datë 25/01/2018 DPSHTRR na vë në dispozicion dosjen e plotë të mjetit në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

Arsyetimi ligjor:

Autovetura tip Mazda është blerë me kontratë qiraje financiare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.06.2011.

Si burim të ardhurash për pagesën e kësaj shume subjekti i rivlerësimit deklaron të ardhurat e siguruar nga pagesa e pensionit ushqimor të ish-bashkëshortit dhe të ardhurat nga paga e saj. Për të provuar aftësinë paguesë të subjektit të rivlerësimit për pagesën e kësaj të parë për blerjen e kësaj makine është kryer analiza e mëposhtme financiare.

| Viti 2011 | | | | Diferenca (I-II) |
|---|-----------------------|---|-----------------------|------------------|
| Të ardhurat deri në fund të qershorit 2011 (I) | 1,501,947 lekë | Shpenzimet deri në fund të qershorit 2011 (II) | 1,149,588 lekë | |
| Paga e subjektit | 501,947 | Shpenzimet e jetesës sipas ILDKPKI | 270,000 | |
| Pensioni ushqimor | 1,000,000 | Pagesë për blerjen e makinës tip Mazda | 879,588 ⁶ | 352,359 |

Në tabelën e mësipërme janë pasqyruar:

- Të ardhurat e subjektit të rivlerësimit** deri në fund të qershorit të vitit 2011 ku përfshihen të ardhurat nga paga dhe të ardhurat nga pensioni i nënës.

Në vitin 2011 subjekti i rivlerësimit deklaron si të ardhura dhe shumë prej 1,000,000 lekësh që përbën pensionin ushqimor të fëmijëve të saj dhënë nga ish-bashkëshortit, por nuk ka deklaruar datën e saktë të marrjes së kësaj shume.

Shpenzimet e subjektit të rivlerësimit ku përfshihen shpenzimet minimale të jetesës sipas ILDKPI-së, pagesa e qirasë së apartamentit të banimit dhe pagesa për blerjen e makinës. Meqënëse për shpenzimet e arredimit nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është deklaruar muaj kur janë realizuar gjatë vitit 2011, ato nuk janë përfshirë si shpenzime deri në fund të qershorit 2011.

⁶ Konvertuar me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2011

Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka patur mundësi financiare për kryerjen e këtij shpenzimi.

2. Afati i kontratës së qirasë financiare ka qenë 60 muaj ose 5 vjet. Më datë 14.05.2013 me kontratë shitje nr. *** Rep. dhe Nr. *** kol., datë 14.05.2013 subjekti i rivlerësimit është bërë pronare e makinës.
- Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar grafiku i pagesave për shlyerjen e makinës nga ana e saj:

| Data e pagesës | Shuma e shlyer në Euro | Shuma e shlyer në Lekë |
|-----------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| 21/06/2011 | 195.73 | 27,069 |
| 21/07/2011 | 195.73 | 27,069 |
| 21/08/2011 | 195.73 | 27,069 |
| 21/09/2011 | 195.73 | 27,069 |
| 21/10/2011 | 195.73 | 27,069 |
| 21/11/2011 | 195.73 | 27,069 |
| 21/12/2011 | 195.73 | 27,069 |
| 21/01/2012 | 195.73 | 27,347 |
| 21/02/2012 | 195.73 | 27,347 |
| 21/03/2012 | 195.73 | 27,347 |
| 21/04/2012 | 195.73 | 27,347 |
| 21/05/2012 | 195.73 | 27,347 |
| 21/06/2012 | 195.73 | 27,347 |
| 21/07/2012 | 195.73 | 27,347 |
| 21/08/2012 | 195.73 | 27,347 |
| 21/09/2012 | 195.73 | 27,347 |
| 21/10/2012 | 195.73 | 27,347 |
| 21/11/2012 | 195.73 | 27,347 |
| 21/12/2012 | 195.73 | 27,347 |
| 21/01/2013 | 195.73 | 27,443 |
| 21/02/2013 | 195.73 | 27,443 |
| 21/03/2013 | 195.73 | 27,443 |
| 21/04/2013 | 195.73 | 27,443 |

| | | |
|--------------|---------------|------------------|
| 14/05/2013 | 6,350.90 | 890,460 |
| Total | 10,853 | 1,517,888 |

- Nga analiza financiare e periudhës së pagesës së kredisë rezulton se:

| Viti 2011 | | | | Diferenca (I-II) |
|---|------------------|--|------------------|-------------------------|
| Të ardhurat (I) | 1,993,645 | Shpenzimet (II) | 1,800,361 | |
| Nga pagat e Subjektit | 1,003,894 | Shpenzimet e jetesës sipas ILDKPKI | 540,000 | |
| Nga pensioni ushqimor për fëmijët | 1,000,000 | Arredim shtëpie | 100,000 | |
| Mbetje nga viti i kaluar në llogari bankare | -10,249 | Udhëtime ⁷ | 91,278 | |
| | | Shlyerja e makinës (7,000€+1,370€) | 1,069,074 | 193,284 |
| Viti 2012 | | | | |
| Të ardhurat (I) | 1,246,645 | Shpenzimet (II) | 1,263,888 | |
| Nga pagat e Subjektit | 1,006,645 | Shpenzimet e jetesës | 540,000 | |
| Nga pensioni ushqimor për fëmijët | 240,000 | Udhëtime | 92,215 | |
| | | Shpenzime qeraje ⁸ | 240,000 | |
| | | Shlyerja e makinës | 328,169 | |
| | | Shtesë në gjendjen e llogarisë bankare | 63,504 | (-17,243) |
| Viti 2013 | | | | |
| Të ardhurat (I) | 1,336,336 | Shpenzimet (II) | 1,741,265 | |
| Nga pagat e Subjektit | 1,035,814 | Shpenzimet e jetesës | 540,000 | |
| Nga pensioni i nënës ⁹ | 60,522 | Shpenzime qeraje | 180,000 | (-348,316) |

⁷ Sipas deklarimeve të subjektit në përgjigje të pyetësorit për udhëtimin në Greqi së bashku me fëmijët në vitin 2011.

⁸ Shpenzime qiraje për llogaritur nga muaji tetor 2013 sipas deklaramit të subjektit në përgjigje të pyetësorit të datës 29 prill 2018.

⁹ Pensioni i nënës së subjektit për llogaritur nga muaji tetor 2013 sipas deklaramit të subjektit në përgjigje të pyetësorit të datës 29 prill 2018.

| | | | |
|---|-----------------------|--------------------|-----------|
| Nga pensioni ushqimor për fëmijët | 240,000 ¹⁰ | Udhëtime | 21,032 |
| Mbetje nga viti i kaluar në llogarinë bankare | 56,613 | | |
| | | Shlyerja e makinës | 1,000,233 |

Bazuar në tabelën e mësipërme u konstatua se subjekti i rivlerësimit nuk ka patur të ardhura të mjaftueshme për të shlyer kredinë brenda periudhës trivjeçare, në shumën 348,316 lekë.

Pasi u njoh me këtë rezultat të hetimit, subjekti pretendoi se:

“Konstatoj se në të dhënat e pasqyruar në tabelën për tre vitet 2011, 2012, 2013, për të parë nëse unë kisha mundësi financiare për të mbyllur kredinë. Sqaroj se ka pasaktësi në vlerat e vendosura, si më poshtë:

Në tabelën e vitit 2012 nuk është shënuar pensioni i nënës në vlerën 240.000 lekë.

Në tabelën e vitit 2013 është shënuar gabim, pensioni i nënës në vlerën 60.000 lekë, kur në fakt është 240.000 lekë. Sqaroj se në pyetësoin e dt. 29.04.2018, nuk kam pasur pyetje lidhur me pensionin e nënës dhe nuk di nga ka dalë vlera 60,000 lekë e shënuar në tabelë.

Në rast se të ardhurat nga pensioni për vitin 2012 dhe 2013 do të shënoheshin në tabelë, ashtu siç janë në fakt, të deklaruara nga ana ime, në formularët e deklarimit të pasurive, rezultati është $(+193,284) + (+222,757) + (-168,838) = (+247,203)$ lekë, pra jo negativ.”

Nisur nga parashtrimet e paraqitura nga subjekti, Komisioni kontatton se:

- Të dhënat për pensionin e nënës, E.B. janë dhënë nga vetë subjekti në pyetësoin e datës 29.04.2018, në të cilin, pavarësisht se pyetja nuk ishte e drejtpërdrejtë për këtë pension, të dhënat për të janë deklaruar nga subjekti në kuadër të sqarimeve për qiranë e apartamentit ku ka banuar.
- Në përlllogaritjen e bërë nga ana e subjektit janë korigjuar të dhënat për të ardhurat, duke përfshirë pensionin e zonjës E.B., por është harruar pa përfshirë llogaritja e qirasë së plotë të apartamentit, sipas vlerave të vetëdeklaruara, përkatësisht 2012-tetor 2013 në shumën 30 000 lekë në muaj, prej të cilave vetë subjekti ka deklaruar se 20 000 lekë paguheshin nga ajo dhe 10 000 lekë nga e ëma, si dhe tetor 2013- tetor 2015 në shumën prej 20 000 lekësh, që i ka paguar e ëma.

Në këto kushte, nga llogaritja e plotë, Komisioni vëren se rezultati financiar për këto tre vjet është:

Viti 2011 në shumën 193, 284 lekë,

¹⁰ Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka marrë shumën 240,000 dhe jo shumën 640,000 e cila është shënuar gabim.

Viti 2012 në shumën 102, 757 lekë,

Viti 2013 në shumën – 318, 838 lekë.

Në total, vlera për këto tre vjet rezulton: $193\,284 + 102\,757 + (-318\,838) = -22\,797$ lekë.

Në përfundim të analizës financiare të mësipërme konstatohet se, pavarësisht se rezultati nuk del pozitiv, është një shumë relativisht e vogël për ta marrë në konsideratë.

Por nga ana tjetër, në deklaratën periodike të vitit 2012, subjekti ka deklaruar si qira të apartamentit shumën prej 20, 000 lekë në muaj dhe si të ardhura familjare ka përfshirë edhe pensionin e nënës, ndërsa në përgjigje të pyetjeve të Komisionit ka deklaruar si qira të apartamentit shumën prej 30, 000 lekë në muaj. Në këtë deklaratë nuk konstatohet të jetë deklaruar ndonjë shumë si kursime për këtë vit. Në deklaratën e vitit 2013, konstatohet se është deklaruar si e ardhur pensioni i nënës, por nuk është deklaruar si shpenzim qiraja e apartamentit, që është deklaruar në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga ana e Komisionit. Po në këtë vit nuk rezulton asnjë deklaram mbi kursime *cash*.

Komisioni çmon se subjekti ka patur mungesë të ardhurave për shlyerjen e kredisë për blerjen e makinës në një shumë të vogël prej 22, 797 lekë, e cila mund të jetë rrjedhojë e pasaktësive në deklaram të shtesave dhe pakësimeve nga të ardhurat të subjektit të rivlerësimit për vitin 2011-2013.

IV. Në lidhje me deklaratat periodike

1. Deklarata fillestare e pasurisë e vitit 2007

Në deklaratën fillestare të pasurisë subjekti i rivlerësimit deklaron se ka kredi bankare në vlerë totale 15,000 USD, e cila ka filluar në vitin 2002 dhe përfundon në gusht 2010, afat 10 vjet, kësti 199 USD mbetur pa paguar 6500 USD. Me shkresën nr. *** prot., datë 17.01.2018 të Intesa San Paolo Bank rezulton se:

Kredia e deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit në shumën 15,000 USD është lidhur midis palëve K.B. dhe F.B. dhe Intesa San Paolo, pra, kjo kredi nuk ka qenë e lidhur në emër të saj. Pavarësisht këtij fakti në deklaratat periodike të vitit 2007-2009 ajo në seksionin detyrime deklaron pagesën e kësteve të kësaj kredie nga ana e saj.

Duke qenë se kredia është marrë gjatë regjimit martesor të subjektit dhe kolateral është lënë pikërisht kjo shtëpi, duke shtuar këtu faktin që në këtë periudhë ish-bashkëshorti nuk paguan as detyrimin ushqimor për fëmijët, është e kuptueshme dhe ligjrisht e pranueshme pagesa e kredisë nga subjekti, megjithëse nuk është kredimarrës.

Në deklaratën periodike të vitit 2009 subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka shlyer kredinë e marrë në Intesa San Paolo Bank në shumën 4000 USD. Ky deklarimi i saj nuk është i saktë pasi nga gjendja e llogarisë në Intesa San Paolo Bank të F.B. rezulton se më datë 21.1.2010 është depozituar shuma 4.471 USD, e cila është përdorur për shlyerjen e kësaj kredie.

Në lidhje me këtë kredi subjekti i rivlerësimit iu kërkua informacion shtesë. Në kthimin e përgjigjeve ajo pranon faktin që kredinë në Intesa San Paolo Bank nuk e ka në emër të saj, siç ka deklaruar në të gjitha deklaratat e pasurisë periodike. Ajo deklaroi se ka marrë hua shumën 3.200 euro për shlyerjen e kredisë duke qenë se ish-bashkëshorti nuk ishte në gjendje të mirë financiare. Këtë shumë ajo nuk e ka deklaruar si të ardhur në deklaratën periodike të vitit 2009 duke e vënë në kushtet e deklarimit të pasaktë.

Kjo hua sipas deklarimeve të subjektit është shlyer nga ana e ish-bashkëshortit të saj, por për të provuar këtë fakt ajo nuk ka dorëzuar asnjë dokument provues. Në datë 25.04.2018 është thirrur si dëshmitar z. K.B., i cili konfirmoi faktin se nga ana e subjektit të rivlerësimit është marrë hua tek kushëriri i subjektit, L.P., shuma 3.000 euro për të shlyer këtë kredi.

2. Deklarata e Vitit 2008

Në deklaratën e vitit 2008 subjekti i rivlerësimit deklaroi blerjen e makinës Volksäagen me kontratë blerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.02.2006. Vlera e blerjes së mjetit është 150,000 lekë dhe vlera e paguar për zhdoganimin e tij është 170,000 lekë, në total është paguar 320,000 lekë.

Kjo blerje duhej të deklarohet në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2007 duke e vënë subjektin në kushtet e deklarimit të pasaktë.

Nga ana e saj nuk është bërë asnjë deklarim për këtë mjet në deklaratën “Vetting”, për këtë arsye iu kërkua informacion shtesë. Subjekti i rivlerësimit pranon të ketë shitur këtë mjet më datë 15.08.2012 dhe na vë në dispozicion aktin përkatës shitjes. Referuar deklaratës periodike të interesave private të vitit 2012 nga ana e saj nuk rezulton të jetë deklaruar shitja e këtij mjeti. Gjithashtu ajo kishte detyrimin ligjor që të ardhurat e krijuara nga shitja e këtij mjeti në shumën 100,000 lekë t’i deklaronte në deklaratën “Vetting”, veprim i cili nuk është kryer.

Me shkresën nr. *** prot., datë 21.02.2018 i jemi drejtuar DPSHTRR për të kërkuar informacion mbi makinën me targat ***. Me shkresën nr. *** prot., datë 13.03.2018 të DPSHTRR rezulton se mjeti është ende në pronësi të subjekti i rivlerësimit, pra blerësi nuk ka kryer ende regjistrimin e kontratës së shitjes së makinës. Ky fakt nuk ngarkon me përgjegjësi palën shitëse.

Për sa më sipër subjekti i rivlerësimit është në kushtet e deklarimit jo të saktë në deklaratën “Vetting”, në lidhje me të ardhurat e krijuar ndër vite në shumën 100 000 lekë.

3. Deklarata 2013

Në deklaratën periodike të vitit 2013 subjekti i rivlerësimit deklaron se ka marrë pensionin për ushqim për periudhën 6.11-12.2013 në shumën 620,000 Lek. Nëse i referohemi deklaratimeve të subjektit në deklaratën periodike të interesave private të vitit 2012 rezulton se ajo ka deklaruar se ka përfituar shumën 240,000 Lekë si pension ushqimor, rrjedhimisht pensioni ushqimor i përfituar në vitin 2013 duhet të ishte në vlerën 380,000 Lekë për periudhën 6.11-12.11 dhe 1.13-12.13. Në lidhje me këtë fakt asaj iu kërkua informacion shtesë. Në datë 24.05.2018 ajo sqaron se shuma 620,000 lekë është shënuar gabimisht nga ana e saj, pasi ajo ka përfituar vetëm shumën 240,000 lekë. Në analizën financiare të bërë nga ana e Komisionit shuma e marrë në konsideratë është 240 000 lekë.

4. Deklarata 2015

Në këtë vit subjekti deklaron se ka marrë si pension ushqimor shumën 240,000 lekë shumë e cila nuk është në përputhje me deklaratë noteriale nr. *** rep dhe nr. *** kol datë 23.01.2017 nëpërmjet së cilës z. K.B. deklaron se duke filluar nga janari i vitit 2015 deri në përfundim të studimeve të larta të fëmijëve do të paguajë shumën 50,000 lekë.

Për sa më sipër rezulton një mospërputhje midis deklaratimeve të subjekti i rivlerësimit dhe deklaratës noteriale nr. *** rep dhe nr. *** kol në shumën 360,000 lekë. Në lidhje me këtë fakt asaj iu kërkua informacion shtesë. Në datë 24.05.2018 ajo sqaron se: *Për vitin 2015 kam përfituar pension ushqimor në shumën 50000 lekë që nga janari 2015 e në vijim, kjo është bërë me marrëveshje me ish-bashkëshortin, pasi fëmijët vazhdonin studimet, dhe shpenzimet ishin shtuar, si prindër kemi detyrimin të kontribuojmë deri në moshën 25 vjeç sipas Kodit të Familjes.*

Për shkak të mungesës së dokumentacioni është shënuar 240,000 lekë, por në vitin 2016 vlerësova se pavarësisht se nuk kisha dokument fakti që unë e merrja këtë vlerë duhet ta shënoja dhe për vitin 2016 e kam shënuar. Meqënëse ligji për vetingun kërkonte dhe dokumentacion atëherë i kërkova ish-bashkëshortit ta dokumentonte këtë vlerë meqënëse duhet për efekt dokumentacioni, dhe në kushtet që realisht e paguante këtë shumë.

Nga ana e saj nuk është provuar me dokumentacion provues asnjëherë marrja e pensionit ushqimor, siç do të arsyetohet më poshtë.

V. Në lidhje me pensionin ushqimor

1. Në deklaratën VETTING në lidhje me pensionin ushqimor subjekti i rivlerësimit deklaron se ka përfituar shumën 1,960,000 Lekë për periudhën 2007-2014 dhe shumën 1,200,000 lekë për periudhën 2015-2016, në total 3,160,000 lek. Kjo shumë nuk është në përputhje

me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike¹¹ dhe shpjegimet e saj të datës 24.05.2018 nga ku rezulton se ajo në total ka marrë shumën 2,920,000 lekë.

Për sa më sipër në lidhje me pension ushqimor rezulton se ka mospërputhje në shumën 240,000 lekë midis deklaratimit të bërë nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratën VETTING dhe deklarimeve të saj kryer ndër vite.

VI. Nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është depozituar asnjë dokumentacion provues për sa i përket shlyerjes së pensionit ushqimor nga ana e ish-bashkëshortit të saj. Në lidhje me këtë fakt asaj iu kërkua informacion shtesë.

Në përgjigjet e saj subjekti i rivlerësimit nuk dokumenton me dokumentacion justifikues dhënien e pensionit ushqimor duke deklaruar se ai i paguhet *cash*.

- Në lidhje me aftësinë paguese të ish-bashkëshortit, nga hetimi administrativ rezulton se:
- Referuar shkresës së DRSSH Durrës z. K.B. nuk figuron i regjistruar në asnjë subjekt nga janari 2012-janar 2018.
- Nga ana e DRT Durrës informohemi se z. K.B. figuron i regjistruar si person fizik me NIPT *** dhe ka status pasiv që më datë 19.03.2013. Nga verifikimi në sistemin c@ts rezulton se nuk ka asnjë deklaratë tatimore dorëzuar apo të deklaruar online. Gjithashtu nga ana e DRT nuk disponohet asnjë dokumentacion në arkivë.

Ky fakt është pranuar dhe nga ana e ish-bashkëshortit të subjekti i rivlerësimit në deklarinim përpara Komisionit, në datën 25.04.2018, i cili nuk provoi me dokumentacion provues të ardhurat e siguruar nga ana e tij për pagimin e këtij pensionit ushqimor. Ai pretendoi se shumën prej 1, 000, 000 lekë i kishte marrë hua tek disa shokë të tij, por edhe për këtë nuk kishte dokumentacion provues.

11

| Viti | shuma | Periudha |
|--------------|----------------------|-------------------------|
| 2007 | 0 | |
| 2008 | 0 | |
| 2009 | 0 | |
| 2010 | 0 | |
| 2011 | 1,000,000 | 50 muaj 03.2007-05.2011 |
| 2012 | 240,000 | Viti 2012 |
| 2013 | 240,000 | 2013 |
| 2014 | 240,000 | 2014 |
| 2015 | 600,000 | 2015 |
| 2016 | 600,000 | 2016 |
| total | 2,920,000 lek | |

VII. Nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratën VETTING deklarohet se për vitin 2015 dhe 2016 ish-bashkëshorti i saj duke filluar nga data 1.1.2015 ka paguar si pension ushqimor mujor shumën 50,000 lekë.

Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me pensionin ushqimor të fëmijëve, pasi vlerësoi deklarin e bërë nga ish-bashkëshorti përpara këtij Komisioni, subjekti u njoftua me rezultatin e hetimit, se nuk provohet me dokumentacion ligjor marrjen e pensionit ushqimor nga ana e ish-bashkëshortit të saj, ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk justifikon ligjshmërinë e të ardhurave të dhënë si pension ushqimor si dhe ka mungesë burimesh financiare për dhënien e këtij pensioni, subjekti ka mospërputhje në deklarime në lidhje me shumën totale të përfituar si pension ushqimor.

Pasi u njoh me rezultatin e hetimit, subjekti ka parashtruar se:

“Në rastin konkret jemi në kushtet, që shtetasi K.B. ka pasur një detyrim ushqimor me vendim gjyqësor të formës së prerë, në vlerën 20.000 lekë, për dy fëmijë të moshës 12 dhe 8 vjeç. Pas kalimit të viteve, mes nesh është gjetur rruga më e mirë e mundshme, për të eliminuar proceset gjyqësore, për të përmbushur detyrimin ndaj fëmijëve, tashmë të rritur në moshën 20 dhe 16 vjeç. Pavarësisht se marrëveshja është bërë jo në formë shkresore mes nesh, ajo është provuar me:

1. Deklaratën noteriale të vitit 2017 lëshuar nga ish-bashkëshorti K.B.
2. Pohimi i ish-bashkëshortit K.B., i pyetur nga Komisioni.

Pra, ish-bashkëshorti nuk e ka mohuar asnjëherë, dhënien e pensionit ushqimor. Akti shkresor është për efekte provueshmërie kur njëra palë, mohon pohimin e tjetrit.

Përsa i përket burimit të të ardhurave të ish bashkëshortit, barra e provës i bie atij dhe unë nuk mund të përgjigjem, për ligjshmërinë e të ardhurave të tij, për dhënien e pensionit ushqimor.”

Komisioni, pasi vlerësoi edhe parashtrimet e paraqitura nga subjekti, konstaton se subjekti ka si persona të lidhur dy fëmijët, të cilët përfitojnë një pension ushqimor me vendim gjykate. Pensioni ushqimor nuk është e ardhur e tatueshme në bazë të legjislacionit financiar. Për sa i përket burimit të të ardhurave të ish-bashkëshortit, çmohet se subjekti nuk ka patur as detyrimin dhe as mundësinë për të verifikuar një fakt të tillë. Për më tepër që këto të ardhura janë përfituar nga fëmijët e saj.

Në vijim të arsytimit dhe analizës së fakteve, një pjesë e këtyre të ardhurave nga pensioni ushqimor janë përdorur nga subjekti për blerjen e makinës në vitin 2011. Duke qenë se përgjatë viteve 2007-2011, ish-bashkëshorti nuk ka kryer asnjë pagesë dhe rritja e fëmijëve është përballuar nga vetë subjekti me të ardhurat e veta, është lehtësisht e kuptueshme që ky subjekt do të kishte patur mundësi të kursente shumën prej 20, 000 lekë në muaj, që do t'i kishte marrë në mënyrë hipotetike nga ish-bashkëshorti.

Komisioni vlerëson se, pavarësisht se nuk u vërtetua me dokumentacion aftësia paguese e ish-bashkëshortit për pensionin ushqimor, kjo barrë nuk mund t'i ngarkohet subjektit të rivlerësimit.

Konkluzion përfundimtar mbi vlerësimin e pasurisë së subjektit

Pasi u hetua në mënyrë të thelluar mbi të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, rezultoi se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i saktë në deklarinin ndër vite për sa i përket shtesave dhe pakësimeve nga të ardhurat, pasaktësi të cilat kanë ndikuar dhe në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, përkatësisht në vitet 2009 dhe 2012.
- Subjekti i rivlerësimit nuk vërtetoi me dokumentacion aftësinë paguese të ish-bashkëshortit për pensionin ushqimor si dhe marrjen e pensionit ushqimor nga ana e tij,
- Subjekti i rivlerësimit ka mungesa të ardhurash në shuma të papërfillshme, të cilat janë rrjedhojë e mosdeklarimit të shtesave dhe pakësimeve nga të ardhurat ndër vite, përkatësisht për vitet 2011-2013 në shumën prej 22, 797 lekë, si dhe në vitet 2014-2015 në shumën 39, 749 lekë.

Në lidhje me këtë, Komisioni arsyeton se pika 2 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës ka përcaktuar detyrimin e subjektit të dorëzojë/plotësojë një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë. Sipas Kushtetutës, dokumenti ligjor, prej ku fillon të evidentohen përgjegjësitë e subjektit për shkelje disiplinore është pikërisht kjo deklaratë dhe të dhënat që ajo përmban. Kushtetuta e ka lidhur drejtpërdrejt përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit me deklaratën e re të pasurisë, dhe jo me deklarinimet e mëparshme të tij. Këto deklarime, mund të shërbejnë si provë për Komisionin në proces, por nuk mund të jenë shkak për shkarkimin e subjektit. Konkluzioni përfundimtar i Komisionit do të duhet të nxirret nga motivi dhe sjelljet e subjektit, nga mënyra e plotësimit të deklaratës “Vetting” dhe nga të dhënat e hedhura në të. Përdorimi i deklarimeve në vite shërben për të analizuar vlerën e kësaj prove në raport me provat e tjera, me qëllim përcaktimin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë.

Duke analizuar gjetjet e mësipërme, këto pasaktësi dhe mospërputhje nuk u gjykuan si indicie, që të çojnë në lindjen e dyshimeve për të ardhura të pajustificuara apo fshehje të pasurisë, pasi janë në shuma të vogla, që nuk ndikojnë ndjeshëm në nivelin e pasurisë apo të ardhurave të ligjshme të subjektit, si dhe një pjesë e tyre ka qenë objekt hetimi dhe nga ana e ILDKPI-së në vitin 2014, nga ku ka rezultuar që këto pasaktësi nuk kanë arritur nivel të mjaftueshëm për marrjen e masave të mëtejshme. Në këtë vlerësim u mbajt parasysh fakti që subjekti ka qenë i saktë në deklarinin e bërë në deklaratën “Vetting”.

Më tej Komisioni arsyeton se pasaktësitë në deklarinimet e viteve të kaluara nuk lidhen me deklarinin e pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016. Nxjerrja e konkluzionit për “deklarim të pamjaftueshëm”, në lidhje me pasurinë, bëhet mbi bazën e shkakut kushtetues, kur vërtetohet se subjekti, sipas deklaratës “Vetting”, nuk arrin të justifikojë burimin e ligjshëm të pasurisë, apo kur tenton të kryejë fshehje apo deklarim të rremë të pasurisë.

Komisioni çmon se subjekti, pavarësisht se ka patur pasaktësi në deklarime apo mungesë të të ardhurave në momente të caktuara, përgjatë deklarimeve të pasurisë ndër vite, nuk ka patur për qëllim të fshehë apo paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë. Deklarimet e interesave private dhe pasurorë, të paraqitura ndër vite nga subjekti pranë ILDKPKI-së, mund të përdoren si provë nga Komisioni, bazuar në pikën 5, të nenin 32 të ligjit nr. 84/2016, por këto prova duhet të analizohen në raport me provat e tjera, me qëllim përcaktimin e burimit të ligjshëm të pasurisë. Komisioni çmon se, në këtë rast pasaktësitë e konstatuara nuk çmohen se çenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut tek drejtësia.

Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e këtyre pasaktësive, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, Komisioni konstaton se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të veta, si detyrimi kryesor kushtetues i tij.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti Alma Brati ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Për këtë qëllim DSIK ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2017 për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Nga hetimi administrativ nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtare.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 21.12.2017.

Raporti për analizën e aftësive profesionale kryer nga Inspektoriati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë është bazuar te:

- Formulari i vetëdeklarimit, të 3 dokumentave ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumentave të tjerë që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 5 dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 01.07.1992. Pas studimeve, në datën 05.07.1994 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, detyrë të cilën e ka ushtruar gjer më 19.11.2001 kur jep dorëheqjen me dëshirën e saj. Në vijim, më 05.03.2007 është emëruar Inspektore në Inspektoratit e KLD-së, ndërsa në datën 05.04.2010 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Më 20.12.2013 është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku vazhdon dhe aktualisht.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trivjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur gjithsej 2 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (1 ankesë në vitin 2014 dhe një ankesë në vitin 2015). Këto 2 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për subjektin e rivlerësimit përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, nga ana e Komisionit, u bazua në gjetjet e këtij raporti, në shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe pas, një analize të bërë në përputhje me ligjin nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Kreun II të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konstatohet si më poshtë:

a) Lidhur me aftësitë profesionale

Subjekti i rivlerësimit ka njohuri të së drejtës familjare që lidhet me zgjidhjen e martesës dhe birësimet dhe të së drejtës së punës. Ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Ka njohuri formale ligjore, por në ndonjë rast nuk thellohet tek thelbi i institutit për ta zbatuar ligjin korrektësisht. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara nga subjekti i rivlerësimit përgjithësisht janë të qarta dhe të kuptueshme, ndonëse nuk mungojnë rastet kur pjesë të vendimeve gjyqësore iu mungon qartësia. Struktura e

vendimeve të saj nuk është e standardizuar. Në drejtim të qartësisë së arsyetimit, ajo nuk respekton tërësisht rregullat e drejtshkrimit dhe nuk përdor rregullisht të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Nuk mungojnë rastet, kur fjalitë kanë gabime gjuhësore. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara nuk çënon standardin e procesit të rregullt ligjor.

b) Lidhur me aftësinë organizative

Subjekti i rivlerësimit ka patur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal. Ajo ka respektuar afatet standarde të gjykimit të çështjeve që i janë caktuar, si dhe ka arsyetuar pa vonesë vendimet gjyqësore. Formalisht subjekti i rivlerësimit i kryen procedurat gjyqësore, megjithatë ajo nuk arrin të përfundojë gjykimet me seanca produktive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short është konstatuar se aktet themelore janë të rregullta, të sakta dhe të plota. Megjithatë, në 4 dosje janë konstatuar mangësi.

c) Lidhur me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

Subjekti i rivlerësimit, nisur nga rezultati i ankesave për këtë subjekt dhe verifikimi i tyre për periudhën e rivlerësimit, ka treguar angazhim dhe etikë në punë.

Nga shqyrtimi i dosjes për këtë subjekt nuk kanë rezultuar të dhëna në lidhje me ndikimin apo presion të jashtëm. Për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur 5 ankesa në Komision, të cilat nuk paraqesin indicie për veprime të kryera që çënojnë integritetin apo përbëjnë gjetje për paanësinë e saj gjatë ushtrimit të detyrës.

d) Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional

Për shkak të funksionit të gjyqtarës së shkallës së parë, subjekti i rivlerësimit Alma Brati i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë dhe është çertifikuar në 15 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

Të dhënat tregojnë se ajo ka marrë pjesë në 28 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trivjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarës së shkallës së parë, në përbërje të dhomës civile (seksioni familjar dhe seksioni i përgjithshëm).

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është bazuar edhe në 5 denoncime të bëra pranë Komisionit. Pas shqyrtimit të këtyre denoncimeve, konstatohet se në asnjë prej tyre nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njënashme apo korruptive nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Në analizë të raportit të vlerësimit të kryer nga KLD, si dhe të shpjegimeve të dhëna nga vetë subjekti, Komisioni vlerëson se mangësitë e konstatuara në vlerësimin profesional janë formale dhe nuk janë të asaj shkalle sa të çënojnë aftësitë profesionale të gjyqtarit.

Për sa më sipër unë, Genta Tafa (Bungo), në cilësinë e relatores së çështjes, pasi hetova raportin e KLD-së dhe denoncimet, nuk gjeta indicie apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi të theksuara profesionale apo cilësi që çënojnë figurën e gjyqtarit, propozoj për subjektin Alma Brati: “I aftë”.

D. KONKLZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE:

Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe nenit 59 pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit e rivlerësimit, znj. Alma Brati, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

ANËTARËT E TRUPËS GJYKUESE

PAMELA QIRKO

Kryesuese

LULZIM HAMITAJ

Anëtar

GENTA Tafa (BUNGO)

Relatore

OLSIDA GOXHAJ

Sekretare gjyqësore

U shpall në Tiranë, më datë 05.07.2018.